



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Nr: 3-111-25275

Datë: 17.05.2017

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe në nenin 29 të Ligjit të Shëndetësisë Nr. 2004/4 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr 14/2011 për rregullimin e procedurave të Themelimit të Punës në Sektorin Publik, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

KONKURS INTERN

Për plotësimin e vendeve të punës

I

I.Një Udhëheqës/e për Njësien e Mjekësisë Familjare

Emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës

1. Është përgjegjës për organizimin e punës në njësien e mjekësisë familjare në QKMF si dhe kujdeset për mbulimin e të gjitha punkteve shëndetësore me mjek familjar ose mjek të praktikës së përgjithshme, përgadit orarin dhe e dërgon për aprovim Drejtorit të QKMF-së po ashtu njofton Udhëheqësin për Administratë dhe Personel të QKMF për planet e pushimeve vjetore të mjekëve.
2. Merret me përparimin, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, rregullimet dhe me lëndimet (zbatimin e konceptit të mjekësisë familjare) edukimin shëndetësor imunizimin dhe vaksinimin, përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor duke përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike, udhëzon të specialisti konsulltat në përputhje me sistemin e referimit.
3. Mban përgjegjësi për kontrollimin hulumtimin diagnostifikimin trajtimin këshillimin përcjelljen e vazhdueshme të pacientit, pa marrë parasysh moshën apo gjininë dhe po ashtu për saktësinë e të dhënave të regjistruara në dokumentacionin dhe evidencën shëndetësore gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore, që përmbajnë të dhëna për identitetin personal të pacientit, diagnozën dhe udhëzon infermieret për asistim.
4. Raporton për shërbimet e tij, Drejtorit duke respektuar kodin etik dhe mos cenuar të drejtat e pacientit dhe duke siguruar fshehtësinë profesionale dhe eka detyrë të mbledh të dhënat shëndetësore dhe të raportoje në raporte javore dhe mujore dhe i nënshtrohet orarit të punës nga ora 7 të mëngjesit deri në ora 15 të ditës sikur Udhëheqësi i tjer të QKMF-së.
5. Kryen shërbime të shëndetit riproduktiv kujdesin antenatal dhe postnatal shërbime shëndetësore për fëmijë.
6. Organizon dhe kërkon nga mjekët familjarë të kryen vizita shtëpiake për pacientet në gjendje terminale dhe të palevizshëm sipas Ligjit të Shëndetësisë.
7. I përgjigjet situatave emergjente dhe gjendjeve të jashtëzakonshme në çdo kohë dhe kërkon mbështetje në rast të situatave emergjente kurse me kërkesën e shefit të emergjencës përmes Drejtorit organizon mbulimin e njësive Emergjente me mjek familjar ose me mjekë të Përgjithshëm.
8. Merr pjesë në mbledhjet të cilat i fton Drejtori në të cilat shqyrtohen tema të ndryshme profesionale apo çështje organizative në nivel të QKMF-së.
9. Udhëheqësi i njësive të mjekësisë familjare merr pjesë në edukimin e vazhdueshëm profesional të organizuar në QTMF dhe bën vlerësim të specifikuar për nevojat për trajnimin dhe zhvillimin profesional përmes kordinatorit të QTMF ose Drejtorit të QKMF-së dhe trajnimet e organizuara nga QZMHF-MSH.

Kushtet dhe kriteret :

- Specialist /e e Mjekësis Familjare.
- Licenca nga Ministria e Shëndetësisë.
- Çertifikata Shëndetësore.
- Çertifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore-Lipjan .

Paga mujore:

Koficienti: 9.6 / me pagë mujore prej 725.01.€ (shtatëqind e njezet e pesë euro e një,cent)

II

I.Një Udhëheqës/e për Njësin e Radiologjis

Emërtimi, natyra, lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës

1. Është përgjegjës për organizimin e punës në njësin e radiologjis në QKMF-së po ashtu njofton Zyren e Administratë dhe Personelit të QKMF-së për planet e pushimeve vjetore të teknikëve të RTG ose infermier/e të certifikuar për RTG.
2. Ofron mbrojtjen primare shëndetësore për pacientin dhe familjen.
3. I përgjigjet nevojave të QKMF-së.
4. Mbykëqyr paisjet mjekësore të Diagnostikës
5. Kryen shërbimet të diagnostikes me Echo, Mamograf dhe Rtg .
6. Promovon/edukimin shëndetësor në shoqëri.
7. Bën interpretimin profesional të Radiografive dhe të Echo.
8. Kujdeset për sigurimin e mjeteve të punës, si sigurimin e dozimetrave kundër rrezatimit.
9. Siguron mjetet mbrojtëse për punëtorët dhe për pacientin.
10. Raporton për shërbimet të tij, Drejtorit duke respektuar kodin etik dhe mos cenuar te drejtat e pacientit dhe duke siguruar fshehtësinë profesionale dhe eka për detyr të mbledh të dhënat shëndetësore dhe ti raportoj në raporte javore dhe mujore dhe i nënshtrohet orarit të punës nga ora 7 të mëngjesit deri në ora 15 të ditës sikur Udhëheqësit e tjer të QKMF-së.
11. Gjatë punës së tij i asistojnë tekniket e rengenit-infermier/e të qertifikuar për RTG .
12. Merr pjesë në mbledhjet të cilat i fton Drejtori e ne të cilat shqyrtohen tema të ndryshme profesionale apo çështje organizative në nivel të QKMF-së.

Kushtet dhe kriteret :

- Specialist/e i Radiologjis, Specialist i Mjekësis Familjare.
- Licenca nga Ministria e Shëndetësisë.
- Çertifikata Shëndetësore.
- Çertifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore-Lipjan .

Paga mujore:

Koficienti: 9.6 / me pagë mujore prej 725.01.€ (shtatëqind e njezet e pesë euro e një,cent)

Aplikacionet mirren në arhiven e Komunës sporteli Nr.3,dhe dorzohen në të njëjtën zyre bashkë me dokumentacionet për konkurim..

Vërejtje:Dokumentet e pranuar nuk kthehen ndërsa dokumentet e pa kompletuara nuk shqyrtohen .
Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimi në mjetet e informimit si dhe në web faqen e Komunes.

**Drejtori i DSHPS-së
Dr. Avdullah Fazliu**

